

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXVI, nr. 8318  
E enjte, 11 qershor 2026  
Çmimi 0.50 €

## Sot nis beteja për Kupën e Botës



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## MË SHUMË SE NJË SHIFËR: ÇFARË FSHIHET PAS RËNIES SË PJESËMARRJES NË ZGJEDHJE?



Mbi 1.2 milion qytetarë të Kosovës zgjedhën të mos votojnë. Në një vend ku dalja në zgjedhje ka qenë tradicionalisht e lartë, kjo nuk është thjesht

një statistikë - është zile alarmi për sistemin politik, thonë njohësit e zhvillimeve politike dhe sociale. Zgjedhjet e 7 qershorit prodhuan një nga nivelet

më të ulëta të pjesëmarrjes në vitet e fundit, duke ngritur, sipas tyre, pyetje serioze për përfaqësimin, besimin dhe funksionimin e demokracisë

### AKTUALE



**SULME TË KUFIZUARA, SINJAL MË I GJERË: ÇFARË ZBULOI OPERACIONI AMERIKAN NDAJ IRANIT** F. 2

**GJERMANIA, FRANCA DHE SHTETET E BENELUKSIT PROPOZONË TË DREJTË TË KUFIZUAR VOTE PËR ANËTARËT E RINJ TË BE-së** F. 3

**ARSIM BAJRAMI: NË KOHËN E TRANSFORMIMEVE TË MËDHA NDËRKOMBËTARE, KOMUNITETI AKADEMIK TË OFROJË VIZIONE STRATEGJIKE PËR KOSOVËN** F. 6

### EKONOMI



**ASK-ja RAPORTON RITJE VJETORE TË ÇMIMEVE, INFLACIONI NË KOSOVË 6,8 PËR QIND** F. 8

**AZEMI: S'PËRJASHTOHET MUNDËSIA QË SHITESAT PREJ 100 EUROSH PËR SEKTORIN PRIVAT TË MOS EKZEKUTOHEN FARE** F. 8

### SPORT



**KOSOVA SIGURON LIGËN B DHE 'PLAY-OFF'-in E BOTËRORIT 2027** F. 11



**RAMA PARALAJMËRON SHFUQIZIMIN E LIGJIT PËR INVESTIMET STRATEGJIKE** F. 3

**VOTAT E DIASPORËS, 'PËRCAKTUESE' PËR FORMIMIN E INSTITUCIONEVE TË REJA** F. 8



**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 735  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjbiznesi.com](http://www.kolegjbiznesi.com)  
info@kolegjbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# SULME TË KUFIZUARA, SINJAL MË I GJERË: ÇFARË ZBULOI OPERACIONI AMERIKAN NDAJ IRANIT?



**WASHINGTON, 10 QERSHOR** - Sulmet amerikane ndaj sistemeve të mbrojtjes dhe të radarëve të Iranit duket se u kryen për të shërbyer si një paralajmërim i kufizuar ndaj Teheranit dhe jo si goditja e parë e një fushate më të gjerë ushtarake, sipas zyrtarëve të lartë amerikanë dhe ekspertëve rajonalë të sigurisë.

Sulmet kishin në shënjestër disa sisteme iraniane të mbrojtjes ajrore dhe radarëve.

Mediet shtetërore iraniane raportuan për shpërthime në disa lokacione në provincën e Hormozganit, përfshirë Sirikun, Bandar Abasin, Minabin dhe në ishullin Keshm.

Sulmet erdhën në një moment delikat në raportet ShBA - Iran, teksa administrata e presidentit amerikan, Donald Trump, vazhdon ta ndjekë rrugën e negociatave me Teheranin, pavarësisht prej rritjes së tensioneve ushtarake në Gjirin Persik.

Disa zyrtarë amerikanë që folën me gazetarët thanë se nuk presin që veprimi ushtarak t'i devijojë përpjekjet diplomatike. Megjithatë, më 10 qershor, zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme iraniane, Esmail Baghaei, tha se po shqyrtohet nëse mund të vazhdojnë negociatat me ShBA-në pas sulmeve. Baghaei tha se po vlerësohet ndikimi i përplasjes ushtarake në bisedimet me Uashingtonin.

Një zyrtar i lartë amerikan tha pas sulmeve se presidenti amerikan Donald Trump ende beson se mund të arrihet një marrëveshje e paqes me Iranin, duke theksuar se “nuk ndryshon asgjë se ku qëndron situata aktualisht sa i përket marrëveshjes”.

Në të njëjtën kohë, një tjetër zyrtar amerikan i përshkroi sulmet si “goditje

paralajmëruese”, duke sugjeruar se Uashingtoni synonte ta shfaqte gatishmërinë për t'u përgjigjur ushtarakisht dhe njëkohësisht duke shmangur hapat që do të mund të nxisin një konflikt më të gjerë.

## Qëndrimi i Kongresit

Operacioni vjen pas presionit në rritje nga ligjvënësit amerikanë, pas raportimeve për përfshirjen e Iranit në rrëzimin e një helikopteri amerikan Apache.

Duke folur në një konferencë për medie, kryetari i Dhomës së Përfaqësuesve, Mike Johnson nga Louisiana, tha se ishte informuar për atë që ai e përshkroi si “sulme të shënjestruara”, të cilat, sipas tij, ishin “të natyrës mbrojtëse” kundër Iranit.

Johnson shtoi se kishte marrë pjesë në një takim në Dhomën e Situatave më herët gjatë 9 qershorit me presidentin Trump, nënpresidentin JD Vance, sekretarin e Shtetit Marco Rubio, sekretarin e Mbrojtjes, Pete Hegseth, dhe zyrtarë të tjerë të lartë, ku Irani ishte ndër temat e diskutuara.

Zyrtarë të lartë ushtarakë, po ashtu, sinjalizuan se një përgjigje ishte duke u shqyrtuar edhe para se sulmet të bëheshin publike. I pyetur për reagimin e ShBA-së ndaj incidentit me helikopterin, teksa po largohej nga një mbledhje e klasifikuar në Kongres, admiral Brad Cooper u përgjigj shkurt: “Do të shohim”. Republikanët në Kongres ishin më të drejtpërdrejtë. Kryetari i Komitetit të Shërbimeve të Armatosura në Dhomën e Përfaqësuesve, Mike Rogers, argumentoi se Uashingtoni nuk mund të lejonte që rrëzimi i një helikopteri amerikan të mbetet

pa përgjigje. “Duhet të përgjigjemi me forcë”, tha Rogers. “Nuk mund të lejojmë që dikush të rrëzojë një nga helikopterët tanë dhe të mos ketë përgjigje”. Ai shtoi se Trumpi duhet të shqyrtojë “opsione domethënëse”.

Më herët gjatë 9 qershorit, senatori Ted Cruz bëri thirrje për veprim ushtarak, duke shkruar në rrjete sociale se “ekziston një nevojë urgjente që ShBA të përgjigjet ndaj këtij sulmi”.

Edhe kongresisti demokrat Josh Gottheimer mbështeti një reagim të fortë në kohën kur u bënë publike raportimet për sulmet, duke thënë se Irani kishte tentuar të vriste pjesëtarë të forcave amerikane dhe duke vlerësuar “trimërinë dhe reagimin e shpejtë” të ushtrisë. Mbështetja dypartiake për hakmarrje tregoi se sulmet ndaj personelit amerikan vazhdojnë të prodhojnë presion të fortë politik në Uashington, edhe mes ligjvënësve që kanë qëndrime të ndryshme për politikën më të gjerë në Lindjen e Mesme.

## Ekspertët shohin një mesazh të kalibruar, jo një marsh drejt luftës

Analistët e sigurisë, të intervistuar nga Radio Evropa e Lirë, i interpretuan kryesisht sulmet si një përgjigje e kujdesshme dhe e kalibruar, që synon ta forcojë parandalimin, duke ruajtur njëkohësisht hapësirë për diplomaci.

Zëvendësadmirali në pension Robert Murrett, i cili më parë ka drejtuar Agjencinë Kombëtare të Inteligjencës Gjeohapësinore të ShBA-së, tha se e sheh operacionin kryesisht si një veprim i kufizuar mbrojtës dhe

jo si sinjal për përshkallëzim më të gjerë.

Murrett vuri në dukje përshkrimin e sulmeve nga Komanda Qendrore e ShBA-së si “proporcionale”, duke argumentuar se një gjuhë e tillë është domethënëse, pasi tregon përpjekje për ta kufizuar përplasjen e jo për ta zgjeruar atë.

Ai theksoi se mbeten paqartësi lidhur me rrethanat e rrëzimit të helikopterit, duke thënë se raportimet sugjerojnë se ende nuk është e qartë nëse fluturakja është rrëzuar qëllimisht apo nëse incidenti lidhet me një aksident të shkaktuar nga një dron iranian.

Në një kuptim më të gjerë, Murrett argumentoi se si Uashingtoni ashtu edhe Teherani duket se po synojnë të shmangin veprime që do ta rrezikonin mundësinë e një marrëveshjeje të negociuar.

Sipas Murrett, presioni ushtarak dhe diplomacia po zhvillohen paralelisht, me asnjërin palë që nuk dëshiron të ndër marrë hapa aq të ashpër sa të përjashtojnë një rezultat të mundshëm diplomatik në të ardhmen. Megjithatë, ai paralajmëroi se një periudhë e zgjatuar e konfrontimit të kufizuar mbetet e mundshme, ndërsa negociatorët përballen me çështje të vështira, përfshirë programin bërthamor të Iranit, sigurinë detare në Ngushticën e Hormuzit dhe çështjet që lidhen me asetet iraniane të ngrira.

Dan Arbell, ish-diplomat izraelit dhe profesor në Universitetin Amerikan në Uashington, dha një vlerësim të ngjashëm. Ai e përshkroi operacionin si një përgjigje e kufizuar dhe tha se nëse Irani zgjedh të mos hakmerret, sulmet mund të krijojnë në fakt një mundësi që

bisedimet të rifillojnë.

Pas sulmeve amerikane Irani gjuajti raketa dhe dronë drejt bazave amerikane në Lindjen e Mesme, por një zyrtar amerikan tha se pothuajse të gjitha fluturaket u penguan. Ai argumentoi se, pas incidentit me helikopterin Apache, Uashingtoni me gjasë është ndier i detyruar të tregojë se sulmet ndaj forcave amerikane nuk do të mbeten pa përgjigje. Në të njëjtën kohë, ai e përshkroi operacionin si një përdorim “kirurgjikal” dhe “taktik” i forcës, i kryer në mënyrë të përmbajtur.

Për Arbellin mesazhi ndaj Teheranit është i dyfishtë: Shtetet e Bashkuara do të reagojnë kur personeli i tyre të jetë në shënjestër, njëkohësisht mbetet e përkushtuar për të ndjekur negociatat që synojnë uljen e tensioneve, rihapjen e rrugëve detare dhe adresimin e mosmarrëveshjes së gjatë mbi programin bërthamor të Iranit. Sfida e administratës amerikane tani do të jetë t'i bindë aleatët dhe kundërshtarët se hakmarrja ushtarake dhe diplomacia nuk përjashtojnë njëra-tjetrën.

Duke shënjestruar sistemet e mbrojtjes ajrore dhe radarët, në vend të infrastrukturës më të gjerë strategjike, Uashingtoni duket se ka zgjedhur një opsion që synon t'i shkaktojë kosto Iranit, duke kufizuar njëkohësisht rrezikun e një përshkallëzimi më të gjerë rajonal.

Përsëritja nga zyrtarët amerikanë se sulmet janë një “goditje paralajmëruese” dhe se negociatat mbeten “afër” sugjeron se Shtëpia e Bardhë po përpriqet ta balancojë parandalimin me diplomacinë.

## RAMA PARALAJMËRON SHFUQIZIMIN E LIGJIT PËR INVESTIMET STRATEGJIKE

TIRANË, 10 QERSHOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, paralajmëroi se së shpejti do të shfuqizohet Ligji për Investimet Strategjike. Kërkesën për shfuqizimin e këtij ligji e ka bërë Bashkimi Evropian.

Në një konferencë për medie me gazetarë nga vendet e BE-së, Rama tregoi arsytet e këtij vendimi që, sipas tij, nuk kanë lidhje me protestat që po mbahen sa i përket projektit në Zvërnec, afër Vlorës. "Ligji kurrë nuk ka qenë i padrejtë, por gjëja e mirë është që do ta lëmë jashtë sepse e ka përmbushur misionin e vet. Nuk është se po luftojmë për të, nuk është se do të themi që vlerësimi [i BE-së] është i gabuar, thjesht do ta lëmë jashtë. Nuk ka të bëjë me asgjë çfarë ndodh në rrugë. Nuk ka të bëjë me asgjë që sillt përreth kësaj historie", tha ai.

Mijëra njerëz po protestojnë në Tiranë, në qytete të tjera të Shqipërisë, si dhe në disa shtete të botës, duke kundërshtuar punimet për ndërtimin e një resori në Zvërnec, pranë Vlorës, mes shqetësimeve lidhur me ndikimin në mjedis dhe mosmarrëveshjeve mbi pronësinë e tokës.

Zvërneci gjendet në zonë të mbrojtur që është habitat për flamingot, fokat dhe shumimin e breshkave të detit. Flamingoja është shndërruar në simbol të protestave, me demonstruesit që mbajnë në duar zogjtë rozë dhe pankarta me mbishkrimin "Revolucioni i Flamingos". Shfuqizimi i Ligjit për Investimet Strategjike është një nga kërkesat e protestuesve.

Një ditë më parë zëdhënësi i Komisionit Evropian, Guillaume Mercier, tha për Radio Evropa e Lirë se "zgjatja e afatit të

funkcionimit të Ligjit për Investimet Strategjike vazhdon të ngrejë shqetësime lidhur me ndikimet e mundshme mjedisore, veçanërisht në zonat e mbrojtura".

KE-ja ka shprehur shqetësim se projekti i planifikuar në zonën e mbrojtur Pishë Poro-Nartë mund të ketë ndikime mjedisore që bien në kundërshtim me procesin e negociatave të anëtarësimit mes Shqipërisë dhe BE-së.

Kryeministri shqiptar Edi Rama e mbrojti ligjin duke theksuar se ka ndihmuar që shumë investime të shkonin në Shqipëri. Por, sipas tij, vendit nuk i duhet më ky ligj sepse investitorë të mëdhenj po shkojnë dhe nuk kanë nevojë për lehtësitë që ofron ligji. Ai tha se po punohet për një ligj të ri për investimet, bashkë me bllokun evropian. "Është diçka e shkruar qysh para shumë kohe dhe fundi i 2027-s është vendosur aty [si afat], por mund ta bëjmë edhe më parë. Ligji i ri kërkon kohë sepse Komisioni duhet ta shohë. Në qoftë se ligji është gati këtë vit, do ta miratojmë këtë vit", u shpreh ai.

Ligji për Investimet Strategjike u miratua në vitin 2015 me një afat trevjeçar, por që prej asaj kohe afati i funksionimit të tij është shtyrë gjashtë herë. Ligji ofron lehtësira procedurale, fiskale dhe administrative, investime publike, dhënie e tokës publike dhe ndërhyrjen e shtetit për shpronësim të pronës private e të tjera lehtësira për ata që përfitojnë statusin "investitorë strategjikë". Prej katër vjetësh BE-ja në raportet e progresit për Shqipërinë ka kërkuar rishikimin e këtij ligji. Dy vjet



më parë ambasadori i BE në Tiranë tha se ky ligj u jep status preferencial atyre që konsiderohen investitorë strategjikë, të cilët më pas përfitojnë tokë në kushte shumë preferenciale ose ndonjëherë edhe me çmim shumë të ulët, nën çmimin e tregut. Ai kishte shprehur shqetësimin se i gjithë procesi që çon në përzgjedhjen e investitorëve strategjikë është disi jotransparent, veçanërisht në jug të Shqipërisë.

Për këtë ligj ka pasur debate të vazhdueshme edhe në Shqipëri, pasi opozita dhe ekspertët e kanë kundërshtuar.

Në dhjetor të 2024-s Qeveria e Shqipërisë i dha statusin e investitorit strategjik kompanisë së dhëndrit të Donald Trumpit, Jared Kushner, për të ndërtuar një resor luksoz në ishullin e Sazanit.

Komiteti për Investime Strategjike, që udhëhiqet nga Rama, pranoi propozimin e kompanisë Atlantic Incubation Partners LLC, për projektin prej 45 hektarësh në ishullin e Sazanit. Projekti parasheh një

investim prej 1.4 miliard eurosh. Në lidhje me projektin që Kushner tha se do të investonte në Zvërnec, Rama ka thënë më herët se nuk ka pasur kërkesë për status të investitorit strategjik.

Në përgjigjet e pyetjeve të gazetarëve evropianë, Rama këmbënguli se nuk ka asnjë projekt as për Sazanin dhe as për Zvërnecin, por janë vetëm ide apo vizione. "Për Sazanin nuk ka nevojë për një projekt, por marrëveshje sepse nuk po e shesim ishullin. Kurrë nuk kanë kërkuar ta blejnë ishullin. Edhe po të kërkonin, neve kurrë nuk na ka shkuar ndonjëherë nëpër mend alternativa për ta shitur ishullin. Ishulli u përket shqiptarëve dhe do të vazhdojë të jetë pasuri e Republikës së Shqipërisë. Do të ketë pronësi të objektit", tha ai.

Rama tha se Korporata Shqiptare e Investimeve është ajo që duhet t'i bëjë negociatat për të pasur pjesë në pronësinë e investimit, duke theksuar se shteti shqiptar do të fitojë prej këtij investimi.

Ndërkaq sa i përket investimit në Zvërnec, Rama tha se kjo ide është paraqitur dy vjet më parë. "Projekti i Zvërnecit si vizion, pra vizualisht është paraqitur dy vjet më parë nga një arkitekt që përfaqësonte investuesit përpara sesa grupi të bëhej më i madh. Kishte ca skica asokohe që Jared [Kushner] i ka publikuar në 'Twitter'-in e vet. Ato kurrë nuk erdhën deri te ne, por u paraqitën në një intervistë dhe, meqë ra fjala, ajo skicë është shumë më e dendur me ndërtim sesa ç'do të jetë. Nuk pati asnjë lloj reagimi që të thoshte mos e prekni [Zvërnecin]", tha Rama.

Gazetarët cituan ambasadorin e delegacionit të BE në Tiranë, Silvio Gonzato, t'u ketë thënë se projekti në Zvërnec është pezulluar, por Rama deklaroi se nuk ka projekt, ndaj nuk mund të flitet as për pezullim dhe as për anulim. "Në qoftë se e ka thënë [ambasadori Gonzato] këtë gjë e ka gabim. Sepse nuk ka projekt të pezulluar. Është gënjeshtrë sepse projekti nuk është pezulluar kurrë, nuk është anuluar kurrë sepse për së pari nuk është miratuar kurrë. Nuk anulon dot diçka që nuk është miratuar. Ndërsa flasim, puna vazhdon për hartimin e tij", tha Rama.

Për pezullim ndërtimesh foli një ditë më parë edhe zëdhënësi i Komisionit Evropian, Guillaume Mercier. Ai tha se Ministria e Mjedisit në Shqipëri u ka bërë me dije bashkëbiseduesve evropianë, gjatë një takimi online, se punimet e ndërtimit janë pezulluar dhe se për projektin do të kryhet një vlerësim i plotë i ndikimit në mjedis në konsultim me shoqërinë civile.

## GJERMANIA, FRANCA DHE SHTETET E BENELUKSIT PROPOZONJË TË DREJTË TË KUFIZUAR VOTE PËR ANËTARËT E RINJ TË BE-së

BERLIN, 10 SHKURT - Një grup shtetesh anëtare të Bashkimit Evropian (BE) kanë propozuar që anëtarët e ardhshëm të bllokut, gjatë një periudhe kalimtare pas pranimit në bllok, të kenë të drejta të kufizuara. Në mesin e kufizimeve kyçe është propozimi që anëtarët e rinj të kenë të drejtë të kufizuara vote. "BE-ja duhet të zhvillojë një diskutim të detajuar mbi mundësinë e kufizimeve të përkohshme, kalimtare të së drejtës së votës për shtetet e reja anëtare, veçanërisht në fushat e acquis-së së BE-së ku kërkohet unanimitet [për shembull zgjerimi, politika e përbashkët e jashtme dhe e sigurisë, korniza shumëvjeçare financiare], duke marrë parasysh ndjeshmërinë juridike dhe politike", thuhet në



të ashtuquajturin non-paper të nënshkruar nga Gjermania, Franca dhe shtetet e Beneluksit (Holanda, Belgjika dhe Luksemburgu).

Radio Evropa e Lirë ka pasur qasje në këtë dokument jozyrtar.

REL i është drejtuar Qeverisë në

detyrë të Kosovës për të marrë një qëndrim për këtë propozim dhe është në pritje të përgjigjes. Non-paper është dokument joformal që përdoret në qarqet diplomatike evropiane për paraqitjen e ideve të reja, testimin e qëndrimeve ose propozimin e zgjidhjeve, pa e

detyruar palën që e paraqet atë të marrë qëndrim formal.

Për momentin, i vetmi shtet me gjasa reale për anëtarësim të ardhshëm në BE është Mali i Zi, pasi Bashkimi Evropian ka marrë vendim për formimin e një grupi ad hoc që do të punojë për hartimin e draft-marrëveshjes së anëtarësimit. Kjo është hera e parë pas 17 vjetësh që BE-ja nis punën për tekstin e një marrëveshjeje anëtarësimi, pas vitit 2009, kur i njëjti proces filloi për Kroacinë. Kroacia është anëtare me të drejta të plota e BE-së që nga viti 2013, që përbën periudhën më të gjatë në historinë e bllokut evropian pa zgjerim, përkatësisht pranim të anëtarëve të rinj.

Vendet e rajonit të Ballkanit

Prendimor janë në faza të ndryshme në rrugën e tyre drejt anëtarësimit. Vetëm Kosova është më prapa, pasi është i vetmi shtet që nuk ka ende statusin e vendit kandidat, ndërkaq aplikimi për anëtarësim që Prishtina e ka dorëzuar në dhjetorin e vitit 2022, Brukseli ende nuk e ka trajtuar.

Në dokumentin e nënshkruar nga Gjermania, Franca dhe shtetet e Beneluksit theksohet se situata gjeopolitike ka ndryshuar ndjeshëm që nga hyrja e Kroacisë në BE dhe se, siç thuhet, zgjerimi nuk shihet më vetëm si një proces teknik i bazuar në merita, por si një investim strategjik në paqen, sigurinë, stabilitetin dhe prosperitetin e Evropës.



# MË SHUMË SE NJË SHIFËR: ÇFARË FSHIHET PAS RËNIES SË PJESËMARRJES NË ZGJEDHJE?

**PRISHTINË, 10 QERSHOR** - Mbi 1.2 milion qytetarë të Kosovës zgjedhën të mos votojnë. Në një vend ku dalja në zgjedhje ka qenë tradicionalisht e lartë, kjo nuk është thjesht një statistikë - është zile alarmi për sistemin politik, thonë njohësit e zhvillimeve politike dhe sociale. Zgjedhjet e 7 qershorit prodhuan një nga nivelet më të ulëta të pjesëmarrjes në vitet e fundit, duke ngritur, sipas tyre, pyetje serioze për përfaqësimin, besimin dhe funksionimin e demokracisë. Nga 1 959 962 qytetarë me të drejtë vote, vetëm 726 071 votuan, ose 37.05 %, sipas Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Krahasuar me rreth 45 % pjesëmarrje në zgjedhjet e dhjetorit të kaluar, rënia është e ndjeshme.

## Abstenimi si revoltë

Sociologu Besim Gollopi në Universiteti "Isa Boletini" në Mitrovicë të Jugut e sheh këtë rënie si pasqyrim të drejtpërdrejtë të zhgënjimit të qytetarëve ndaj klasës politike. Sipas tij, fakti që këto janë zgjedhjet e treta brenda më pak se një viti e gjysmë - pas atyre të 9 shkurtit 2025 dhe zgjedhjeve të parakohshme të 28 dhjetorit - ka prodhuar lodhje të theksuar tek elektorati. "Thirrjet e shpeshta për votim perceptohen si shenjë e një sistemi që nuk arrin të funksionojë normalisht",

vlerëson ai për Radion Evropa e Lirë, duke shtuar se kjo ndikon drejtpërdrejt në uljen e motivimit për pjesëmarrje. Analisti Belgzim Kamberi nga Instituti "Musine Kokalari" në Prishtinë e përkufizon këtë fenomen si një "abstenim revoltues". Sipas tij, qytetarët nuk zgjedhën të ndëshkojnë vetëm një parti - as pushtetin, as opozitën. "Ata, thjesht, ndjenë se nuk përfaqësohen nga asnjëra palë dhe qëndruan në shtëpi. Ky është një reagim racional ndaj një politike që nuk prodhon zgjidhje konkrete", thekson Kamberi për Radion Evropa e Lirë.

## Kriza e besimit dhe cikli i pafund i krizave

Përtej lodhjes zgjedhore, Gollopi nënvizon edhe një problem tjetër: krizën e besimit në politikë. "Vitet e fundit janë karakterizuar nga vështirësi në formimin dhe funksionalizimin e institucioneve, kriza të përsëritura politike dhe një perceptim i përhapur se, pavarësisht se kush i fiton zgjedhjet, jeta e qytetarëve nuk ndryshon", thotë ai. Ky perceptim, i kombinuar me rritjen e kostos së jetesës, pasigurinë ekonomike dhe emigrimin, ka zhvendosur fokusin e qytetarëve larg politikës. "Vëmendja zhvendoset nga politika te sfidat e përditshme. Dhe kjo e bën

pjesëmarrjen në zgjedhje më pak ose aspak prioritare, sidomos për të rinjtë ose për ata që ndihen të shkëputur nga proceset institucionale", shton ai.

## "Zile zgjimi" për partitë politike

Rënia e pjesëmarrjes u vlerësua si shqetësuese edhe nga misionet ndërkombëtare dhe organizatat vendore. Misioni vëzhgues i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (PACE) e cilësoi këtë trend si një "zile zgjimi" për subjektet politike, ndonëse procesin zgjedhor e vlerësoi si të qetë dhe profesional. Organizata "Demokracia në Veprim" (DnV) vlerësoi, po ashtu, se zgjedhjet e fundit u mbajtën në një klimë të qartë lodhjeje zgjedhore dhe me interesim dukshëm më të ulët krahasuar me proceset e fundit. Një nga faktorët, sipas saj, mbetet edhe mungesa e ofertave të reja politike dhe riciklmi i të njëjtave figura dhe premtime gjatë fushatave. Vetë partitë nuk e adresuan drejtpërdrejt këtë fenomen, ndërsa për të tërhoqën vëmendjen disa përfaqësues diplomatikë në vend. Ambasadori britanik në Kosovë, Jonathan Hargreaves, vlerësoi për Radion Evropa e Lirë se "pjesëmarrja e dukshme e ulët në zgjedhjet e së dielës tregon se

durimi i qytetarëve me politikanët po shteron".

## Rezultatet dhe ndryshimet

Sipas të dhënave preliminare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Lëvizja Vetëvendosje (LVV) doli e para me rreth 42 % të votave, e ndjekur nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me rreth 21 %, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me rreth 17 %, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me rreth 7 % dhe Lista Serbe me rreth 6 %. Këto rezultate, ndonëse nuk përfshijnë votat e diasporës, votat me kusht dhe ato të personave me nevoja të veçanta, tregojnë disa ndryshime në pozicionim krahasuar me zgjedhjet e dhjetorit 2025. Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) konsideron se pjesëmarrja e lartë në zgjedhje tregon angazhim qytetar dhe legjitimitet të sistemit politik, ndërsa rënia e saj, sidomos në mesin e të rinjve, është trend në shumë vende. Në një raport të publikuar nga OECD-ja në vitin 2024 thuhet se një në katër të rinj nuk ka fare interes për politikën, krahasuar me një në pesë për të gjitha grup-moshat. "Midis fillimit të viteve 1990 dhe fillimit të viteve 2020, pjesëmarrja në zgjedhjet

parlamentare në të gjithë OECD-në ra nga 75% në 65% mesatarisht", sipas këtij raporti. Ngjashëm, edhe një analizë e Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) tregon se pjesëmarrja globale në zgjedhje ka rënë nga rreth 65% në vitin 2008 në rreth 56% më 2023, duke reflektuar rritjen e skepticizmit ndaj proceseve demokratike.

## Si të rikthehet besimi?

Për ekspertët, rënia e pjesëmarrjes është sfidë politike që kërkon zgjidhje të thella. Kamberi përmend mundësinë e reformave në legjislacionin zgjedhor, duke përfshirë edhe modele si votimi i detyrueshëm, i aplikuar në vende si Belgjika. "Ajo që është e qartë, është se duhet rishikim apo një reformë e thellë e legjislacionit në fuqi për zgjedhjet", pohon Kamberi. Për Gollopin, çelësi mbetet te besimi. "Qytetarët duhet të shohin se zgjedhjet prodhojnë zgjidhje, jo kriza. Vetëm atëherë pjesëmarrja mund të rritet", thotë ai. Ai paralajmëron se abstenimi, megjithëse i kuptueshëm si reagim, në fund është një zgjedhje që mund t'i dëmtojë vetë qytetarët. "Nëse tërhiqemi nga proceset elektorale, rrezikojmë të prodhojmë situata edhe më të pafavorshme për mirëqenien tonë", përfundon Gollopi.

# VOTAT E DIASPORËS, 'PËRCAKTUESE' PËR FORMIMIN E INSTITUCIONEVE TË REJA

Prishtinë, 10 qershor - Votat ende të panumëruara të diasporës për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 7 qershorit pritet të kenë peshë më të madhe dhe të jenë përcaktuese për formimin e institucioneve të reja të Kosovës, vlerësojnë njohës të zhvillimeve politike.

Sipas Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), 104 mijë e 480 votues ishin regjistruar për të votuar përmes postës, ndërsa në 30 përfaqësitë diplomatike të Kosovës në mbarë botën kanë votuar 22 mijë e 414 persona. Por, për ta kuptuar numrin e saktë të votave nga jashtë vendit, duhet që fillimisht ato të verifikohen, proces që nisi pasditen e së martës.

Eugen Cakolli, hulumtues në Institutin Demokratik të Kosovës (KDI), thotë për Radion Evropa e Lirë se numri i madh i votave që pritet të konfirmohen si të vlefshme - që ai vlerëson se mund të jenë mbi 100 mijë - do të kenë ndikim "tejet domethënës" në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve dhe, rrjedhimisht, në ndarjen e mandateve në Kuvendin e Kosovës prej 120 karrigesh. "Nëse i marrim parasysh trendët e vitit 2025, përkatësisht ato të dhjetorit, dhe duke supozuar që Lëvizja Vetëvendosje do të performonte njëjtë, ky subjekt mund të shkojë deri në 53 mandate, që nënkupton një

rritje prej pesë mandatesh, që në suaza normale do t'i merrte dy nga Partia Demokratike e Kosovës, dy nga Lidhja Demokratike e Kosovës dhe një nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, por gjithmonë në varësi të performancës së këtyre subjekteve politike", thotë Cakolli.

Në bazë të rezultateve preliminare - ku përfshihen vetëm votat e rregullta - Lëvizja Vetëvendosje ka fituar 42.95 për qind të votave apo 48 mandate, Partia Demokratike e Kosovës 21.14 për qind të votave apo 24 mandate, Lidhja Demokratike e Kosovës ka fituar 17.60 për qind të votave apo 20 mandate dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës - subjekt që së voni ka vendosur të njihet si Aleanca - ka fituar 7.16 për qind të votave apo tetë mandate.

Cakolli nga KDI thotë se në fund numri i mandateve në Kuvend do të përcaktojë se "kush do të ketë gjasat më të mëdha" për formimin e institucioneve të reja të Kosovës.

Sipas Kushtetutës së Kosovës, kryetari i Kuvendit të Kosovës dhe qeveria zgjidhen me shumicën e votave të deputetëve, pra 61. Po sipas Kushtetutës, pozita e kryekuvendarit i takon partisë që del e para në zgjedhje, në këtë rast Lëvizjes Vetëvendosje. Po ashtu, pas konstituimit të Kuvendit, këtij subjekti i takon të propozojë i pari mandatarin

për qeverinë. Akti më i lartë juridik i shtetit parasheh që në rastin e ekzekutivit, stafeta mund t'u kalojë edhe partive të tjera në rast se fituesi i zgjedhjeve s'arrin ta bëjë shumicën. Por, kjo mbetet në diskrecionin e presidentit, në rastin aktual të ushtrueses së detyrës së presidentit të Kosovës, Albulena Haxhiu, që vjen nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje.

Në legjislaturën paraprake, të dalë nga zgjedhjet e 28 dhjetorit, LV-ja siguroi 57 ulëse në Kuvend dhe me mbështetjen e tetë deputetëve nga komunitetet joshumicë, arriti ta sigurojë shumicën parlamentare dhe duke formuar qeverinë.

Nga 120 vendet në Kuvend, 20 janë të rezervuara për komunitetet joshumicë, prej këtyre dhjetë për komunitetin joserbe dhe dhjetë për komunitetin serb. Sa iu përket dhjetë vendeve për komunitetin serb, bazuar në rezultatet e deritanishme, Lista Serbe do të fitojë nëntë prej tyre dhe një ulëse do ta ketë Partia për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë e Nenad Rashiqit. "Duke e ditur që subjektet nga radhët e komuniteteve pritet të përfaqësohen me numër identik të mandateve, mbase edhe të deputetëve në legjislaturën e re, kjo nënkupton që do të jenë deri në dy deputetë në kuadër të komuniteteve joserbe të cilët mund të kenë ndikim në përcaktimin se a do të kemi

institucione apo jo", thotë Cakolli për Radion Evropa e Lirë.

Ndikimi i votave nga jashtë në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve, sipas Cakollit, kësaj radhe është rritur edhe për shkak të daljes së ulët në zgjedhje në Kosovë.

Më 7 qershor pjesëmarrja ishte 37.02 për qind - apo 725 mijë e 488 votues - më e ulët se zgjedhjet e dhjetorit, kur votuan 906 mijë e 754 persona apo 45.36 për qind e trupit votues.

Lidhur me ndikimin që pritet të kenë votat nga diaspora, pajtohet edhe Lirim Krasniqi, drejtor në organizatën joqeveritare "Germin", që merret me çështje të diasporës. "Pesha e votave nga jashtë në rezultatin përfundimtar mund të jetë ndër më të lartat deri më tani në historinë zgjedhore të Kosovës", thotë ai për Radion Evropa e Lirë.

Duke bërë krahasimin me votimet paraprake, Krasniqi thotë se kësaj radhe pritet të ketë më shumë vota nga jashtë. "Duke u bazuar në përvojën e zgjedhjeve të kaluara dhe në numrin e lartë të votuesve të regjistruar për votim me postë, mund të pritet që numri total i votave me postë të jetë rreth 80 mijë, dhe totali i votave nga jashtë Kosovës të kalojë mbi 100 mijë", thotë ai.

Në zgjedhjet e 7 qershorit u shënuar numri më i lartë i votuesve të regjistruar për votim nga jashtë vendit, me mbi 132

mijë aplikime.

Pas përfshirjes së votave të diasporës, Cakolli pret që përqindja e përgjithshme e pjesëmarrjes në zgjedhje të jetë rreth 41 për qind. "Trendët tregojnë që kemi një interesim të shtuar të votuesve në diasporë e një rënie të interesimit [për të votuar] te votuesve në Kosovë". Sipas Cakollit, nëse trendi i uljes së pjesëmarrjes në votimet në Kosovë vazhdon edhe në të ardhmen, e rritet ai i atyre që jetojnë jashtë vendit, ndikimi i votave nga diaspora mund të jetë edhe më i madh. "Pra, në dhjetor ka qenë dy-tre [ulëse], derisa tani jemi te kalkulimi tek e pesta. Nëse vijohet me një trend të tillë, [ndikimi i votave nga diaspora] mund të rritet edhe më shumë në të ardhmen", thotë Cakolli.

Përderisa votat e rregullta brenda vendit - që rëndom numërohen në klasa menjëherë pas mbylljes së vendvotimeve - u numëruan brenda pak orësh gjatë së dielës - autoritetet zgjedhore tani duhet të numërojnë edhe votat me kusht dhe të personave me nevoja të veçanta, përveç atyre nga diaspora.

KQZ planifikon t'i shpallë rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve më 26 qershor dhe t'i certifikojë më 6 korrik, por këto afate janë vetëm planifikime, pasi do të varet edhe nga ankesat që mund të ushtrojnë palët lidhur me procesin.



# AKTAKUZË NDAJ GJASHTË PERSONAVE PËR NGRITJEN E BARRIKADAVE NË VERI MË 2022

PRISHTINË, 10 QERSHOR - Prokuroria Speciale e Kosovës ka ngritur aktakuzë ndaj gjashtë personave të cilët tha se dyshohen për veprat penale kundër rendit kushtetues. Rasti ka të bëjë me ngritjen e bllokadave në komunat veriore të Kosovës - të banuara me shumicë serbe - më 10 dhjetor 2022, të cilat ishin larguar më 29 dhjetor të atij viti.

Prokuroria Speciale tha se D.M., D.D., M.R., N.J., N.O., dhe S.V., nga 10 dhjetori deri më 29 dhjetor në komunat veriore të Kosovës, "duke vepruar në bashkëkryerje dhe përmes përdorimit të forcës dhe dhunës, kanë penguar institucionet e Republikës së Kosovës në vendosjen e rendit kushtetues, ushtrimin e autoritetit shtetëror dhe kryerjen e detyrave zyrtare në këto komuna".

Sipas organit ndjekës, ndaj 11 personave të tjerë të identifikuar me initiale M.R., A.S., A.F., A.J., R.S., S.A., D.V., S.P., V.R., M.R., dhe M.R., janë pezulluar hetimet, "pasi ata deri më tani janë të paarritshëm" për organet e drejtësisë së Kosovës.

Të gjashtë të akuzuarit, tha Prokuroria, dyshohet se kanë bllokuar rrugët kryesore me mjete të forta, përfshirë kamionë të mbushur me zhavorr, ekskavatorë, autoambulanca, autobusë dhe automjete të tjera. "Po ashtu, nga veprimet e tyre

rezulton se, në rast të ndërhyrjes së Policisë së Kosovës për largimin e barrikadave dhe rivendosjen e lirisë së lëvizjes, pjesëtarët e grupit kanë qenë të gatshëm t'i sulmonin zyrtarët policorë me mjete që kishin në dispozicion", tha Prokuroria Speciale përmes një njoftimi.

Ata dyshohen për veprat penale: Bashkim për veprimtari kundërkushtetues me qëllim të sulmit kundër Rendit Kushtetues të Republikës së Kosovës dhe pengim i personit zyrtar në kryerje të detyrës zyrtare.

## Çfarë kishte ndodhur në dhjetorin e vitit 2022 në veri?

Më 6 dhjetor të vitit 2022 në zyrat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në Mitrovicë të Veriut ishin hedhur dy mjete shpërthyes, por vetëm njëra kishte shpërthyer.

Zyrtarët zgjedhorë në atë kohë po organizonin mbajtjen e zgjedhjeve lokale në veri të Kosovës, pas tërheqjes së kryetarëve serbë në katër komunat në veri, që vinin nga Lista Serbe - partia kryesore e serbëve që gëzon mbështetjen e Beogradit zyrtar - në shenjë pakënaqësie ndaj një vendimi të Qeverisë së Kosovës për reregjistrimin e makinave me



targa serbe në ato RKS - Republika e Kosovës. Për shkak të tensioneve, votimet u shtyn për prillin e vitit pasues. Për shkak të sulmit ndaj zyrave të KQZ-së, autoritetet kishin arrestuar ish-pjesëtarin e Policisë së Kosovës, Dejan Pantiq, më 9 dhjetor në pikën kufitare të Jarinjës, e cila e lidh

Kosovën me Serbinë. Arrestimi i tij rriti edhe më shumë tensionet, me serbët lokalë që më pas ngritën barrikada. Në atë kohë Serbia kishte vendosur në gatishmëri ushtrinë dhe kishte rritur praninë ushtarake në vijën kufitare me Kosovën, përkatesisht në Rashkë të

Serbisë.

Barrikadat ishin larguar më 29 dhjetor, pas ndryshimit të masës së sigurisë së Pantiqit nga paraburgim në arrest shtëpiak. Për sulmin ndaj zyrave të KQZ-së, më 2025 janë dënuar me gjithsej 12 vjet burgim tre persona, përfshirë edhe ish-policin e Kosovës, Dejan Pantiq.

# ARSIM BAJRAMI: NË KOHËN E TRANSFORMIMEVE TË MËDHA NDËRKOMBËTARE, KOMUNITETI AKADEMIK TË OFROJË VIZIONE STRATEGJIKE PËR KOSOVËN



PRISHTINË, 10 QERSHOR - Në ambientet e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës u mbajt Konferenca Shkencore "Ndryshimet gjeopolitike dhe sfidat për shtetin e Kosovës", e cila mblodhi akademikë, profesorë universitarë dhe studiues nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut për t'i diskutuar zhvillimet më të rëndësishme gjeopolitike dhe ndikimin e tyre në të ardhmen e shtetit të Kosovës.

Akademik Arsim Bajrami si iniciator, propozues dhe organizator i kësaj konference, ka thënë se në kohën e transformimeve të mëdha

ndërkombëtare është e domosdoshme që komuniteti akademik të ofrojë analiza shkencore dhe vizione strategjike për sfidat me të cilat përballet Republika e Kosovës.

"Në kuadër të konferencës pata kënaqësinë të prezantoj edhe kumtesën time me temën: 'Ndryshimet gjeopolitike dhe sfidat për shtetin e Kosovës', ku trajtova ndikimin e rendit të ri ndërkombëtar, dinamikat e sigurisë, proceset integruese euroatlantike, sfidat ndaj sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës, si dhe nevojën për forcimin e kapaciteteve kushtetuese, institucionale dhe diplomatike të

shtetit tonë", ka thënë Bajrami.

Ai ka shtuar se kjo konferencë dëshmoi edhe një herë rëndësinë e dialogut shkencor dhe të mendimit akademik në ndërtimin e politikave publike dhe në mbrojtjen e interesave strategjike të Republikës së Kosovës.

"Falënderoj Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, të gjithë referuesit, pjesëmarrësit dhe kolegët për kontributin e tyre në suksesin e kësaj konference, e cila besoj se do të shërbejë si një pikë e rëndësishme referimi për studimet dhe debatet e ardhshme mbi pozitën gjeopolitike dhe të ardhmen euroatlantike të Kosovës", ka thënë Bajrami.

## Suhareka do të bëhet me QKMF të re

PRISHTINË, 10 QERSHOR - Ministri në detyrë i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka njoftuar se pas zotimeve të dhëna, të mërkurën

nënshkruan memorandumin e bashkëpunimit me kryetarin e Suharekës, Bali Muharremaj, për ndërtimin e QKMF-së së re. "Ky

investim, në vlerë prej 4 milionë euro, do t'i sjellë Suharekës një QKMF moderne, me kushte më të mira për pacientët dhe për

profesionistët shëndetësorë. Urime, Suharekë! Vazhdojmë me investime në kujdesin parësor shëndetësor", ka njoftuar Vitia.



# OEAK-u: DASH-I RIAFIRMON MBËSHTETJEN PËR KONSIDERIMIN STRATEGJIK TË GAZIT NATYROR AMERIKAN NË KOSOVË

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 10 QERSHOR - Në diskutimin e organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë mbi temën "Shfrytëzimi i LNG-së amerikane për sigurinë energjetike dhe përafirimin strategjik të Kosovës", zëvendësndihmëssekretari i Departamentit të Energjisë së Shteteve të Bashkuara për Evropën, Euroazinë, Afrikën dhe Lindjen e Mesme, Dan Byers, riafirmoi mbështetjen e Shteteve të Bashkuara për përpjekjet e Kosovës drejt diversifikimit të burimeve të energjisë dhe forcimit të sigurisë energjetike.

Në njoftimin e OEAK-ut thuhet se duke nënvizuar se "siguria energjetike është siguri kombëtare", Byers theksoi se qëndrueshmëria energjetike

matet përmes diversifikimit të burimeve dhe alternativave të furnizimit. Ai vlerësoi rolin e thëngjillit si bazë e sistemit energjetik të Kosovës, por shtoi se gazi i lëngshëm natyror (LNG) mund të bëhet një komponent i rëndësishëm i miksit energjetik të vendit në të ardhmen, veçanërisht në kushtet e rritjes së kërkesës për energji. "Duke folur për potencialin e furnizimit, Byers theksoi se Shtetet e Bashkuara janë prodhuesi më i madh në botë i gazit natyror dhe se kapacitetet amerikane të eksportit të LNG-së pritet të rriten ndjeshëm në vitet e ardhshme. Ai nënvizoi se ShBA-ja tashmë furnizon rreth 60 përqind të importeve evropiane të LNG-së dhe se do të vazhdojë të luajë një rol kyç në mbështetjen e aleatëve evropianë përmes furnizimeve të sigurta dhe të

diversifikuara me energji", thuhet në njoftim.

OEAK më tej bën me dije se Byers theksoi se disponueshmëria e furnizimit nuk është e mjaftueshme pa zhvillimin e infrastrukturës përkatëse, duke nënvizuar rëndësinë e investimeve në ndërlidhje rajonale dhe korridore energjetike që mund ta mundësojnë qasjen e Kosovës në LNG. Në këtë kontekst, ai përmendi përkushtimin e Departamentit të Energjisë për të mbështetur projekte infrastrukturore dhe iniciativa rajonale që forcojnë sigurinë energjetike në Evropën Juglindore. Duke iu referuar rekomandimeve të Odës Amerikane, Byers theksoi rëndësinë e planifikimit afatgjatë, studimeve të fizibilitetit, investimeve



strategjike dhe diplomacisë energjetike për të siguruar që Kosova të jetë e përgatitur për të përfituar nga mundësitë që ofron LNG-ja. Në përfundim, ai riafirmoi gatishmërinë e Departamentit të Energjisë së ShBA-së për ta

mbështetur Kosovën përmes ekspertizës teknike, ngritjes së kapaciteteve dhe bashkëpunimit strategjik, duke theksuar se forcimi i sigurisë energjetike të aleatëve dhe partnerëve mbetet një prioritet i rëndësishëm për Shtetet e Bashkuara.

## AKB-ja: ÇDO DITË VONESË PËR GAZIN AMERIKAN I KUSHTON KOSOVËS MILIONA EURO, QEVERIA TË MARRË VENDIM MENJËHERË

PRISHTINË, 10 QERSHOR - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) ka shprehur shqetësimin e thellë se Kosova, edhe pas më shumë se dy dekadash liri dhe 18 vitesh shtetësi, vazhdon të mos ketë një strategji të qartë dhe afatgjatë për sigurinë energjetike të vendit.

Kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB), Agim Shahini, ka thënë se derisa vendet e rajonit po investojnë në diversifikimin e burimeve energjetike dhe po lidhen me rrjetet moderne të gazit natyror, Kosova rrezikon të mbetet ishulli i fundit energjetik në Evropë, e izoluar nga projektet strategjike që garantojnë zhvillim ekonomik dhe siguri kombëtare. "AKB-ja vlerëson se refuzimi ose neglizhimi i mundësisë për t'u përfshirë në projektet e gazit natyror dhe LNG-së amerikane do të ishte një gabim historik me pasoja të rënda ekonomike, energjetike dhe gjeopolitike për Republikën e Kosovës. Për komunitetin e biznesit, kjo nuk është çështje politike, por çështje mbijetese dhe zhvillimi ekonomik. Pa furnizim të sigurt



dhe të qëndrueshëm me energji nuk mund të ketë industri konkurruese, investime serioze, vende të reja pune dhe rritje ekonomike të qëndrueshme. Bizneset e Kosovës tashmë po përballen me kosto të larta të

energjisë dhe pasiguri në furnizim, duke humbur konkurrueshmërinë në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare. Çdo vonesë në marrjen e vendimeve strategjike po i kushton ekonomisë së vendit

miliona euro dhe po dekurajon investitorët e huaj", ka thënë Shahini, duke shtuar se AKB-ja mbështet fuqishëm bashkëpunimin strategjik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vlerëson se qasja në gazin

amerikan përfaqëson jo vetëm një alternativë energjetike, por edhe një garanci për sigurinë ekonomike dhe gjeopolitike të Kosovës. "AKB-ja i bënë thirrje Qeverisë së Kosovës, Kuvendit dhe të gjitha institucioneve përgjegjëse që t'i ndalin hezitimet, kalkulimet politike dhe zvarritjet administrative. Energjia nuk pret ciklet zgjedhore. Vendimet që nuk merren sot do të paguhen shtrenjtë nesër nga qytetarët dhe bizneset. Ftojme partnerët strategjikë amerikanë dhe institucionet relevante që ta vazhdojnë mbështetjen për projektet energjetike që e lidhin Kosovën me rrjetet moderne rajonale dhe evropiane. Koha për analiza të pafundme ka përfunduar. Tani është koha për vendime të guximshme dhe vizionare. Kosova duhet të zgjedhë mes varësisë energjetike dhe sigurisë energjetike. AKB-ja është qartë në anën e sigurisë, zhvillimit ekonomik dhe partneritetit strategjik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës", ka thënë Shahini.

## Shahini: Biznesi ka nevojë për zë të përbashkët rajonal, jo për kufij dhe pengesa administrative

PRISHTINË, 10 QERSHOR - Agim Shahini, kryetar i AKB-së, ishte pjesë e panelit të organizuar nga OEMVP, ku u diskutua për të ardhmen e odave ekonomike dhe rolin e tyre në zhvillimin e biznesit. Ai theksoi se transformimi i odave nuk duhet të mbetet vetëm në nivel

lokal apo shtetëror. "Në një ekonomi gjithnjë e më të ndërlidhur është jetike që odat e Ballkanit Perëndimor të ndërtojnë një rrjet të fuqishëm rajonal, që flet me një zë të përbashkët për interesat e biznesit, tregtinë e lirë, investimet

konkurrueshmërinë. Bizneset përballen me sfida të ngjashme në të gjithë rajonin dhe zgjidhjet kërkojnë bashkëpunim më të madh, koordinim më të fortë dhe përfaqësim më të unifikuar para institucioneve vendore dhe ndërkombëtare", tha ai.

Shahini ka shtuar se vetëm të bashkuar mund të krijojnë një mjedis më të favorshëm për biznesin, investimet dhe zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm në Ballkanin Perëndimor, në veçanti Kosovë, Maqedoni e Veriut dhe Shqipëri.



## 775 mijë euro investim për ujësjellësin në fshatrat e Shalës në Mitrovicë

**MITROVICË, 10 QERSHOR** - Ministria e Ekonomisë, së bashku me komunën e Mitrovicës dhe KRU Mitrovicën, po financon investimin prej 775 mijë eurosh për furnizim më të mirë me ujë për banorët e fshatrave të Shalës: Melenicë, Zjaq, Maxherë dhe Vllahi.

Kryetari i Mitrovicës, Faton Peci, ka thënë se përmes dy marrëveshjeve, me fazën e parë të investimeve po mundësojnë zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit, ndërtimin e rezervuarëve dhe stacioneve të pompimit si dhe shtrirjen e ujësjellësit në zonat ku nevoja është e madhe. "Investimi do të sigurojë

shërbim më cilësor, menaxhim më të mirë të presionit në rrjet dhe furnizim më të qëndrueshëm me ujë të pijshëm për qytetarët. Institucionet mbeten të përkushtuara për shtrirje të rrjetit në të gjithë fshatrat e komunës së Mitrovicës", ka thënë ai.



## AZEMI: S'PËRJASHTOHET MUNDËSIA QË SHITESAT PREJ 100 EUROSH PËR SEKTORIN PRIVAT TË MOS JEPEN FARE

**PRISHTINË, 10 QERSHOR** - Kryetari i Sindikatës së Punëtorëve të Sektorit Privat, Jusuf Azemi, ka shprehur dyshime se shtesat prej 100 eurosh të premtuara për punëtorët e sektorit privat mund të mos ekzekutohen fare, duke kërkuar sqarime publike nga Ministria e Financave dhe kryeministri në detyrë, Albin Kurti, për vonesat në realizimin e pagesave. Gjithashtu, ai përsëriti se shtesat prej 100 eurosh u miratuan për ekzekutim në kohë fushate.

Azemi në një intervistë për "Ekonomia Online" ka bërë me dije se u është drejtuar publikisht institucioneve përgjegjëse pasi, sipas tij, pas përfundimit të zgjedhjeve, nuk

ka pasur asnjë njoftim zyrtar lidhur me afatin e shpërndarjes së mjeteve për punëtorët e sektorit privat. "Punëtorët e sektorit privat gjithmonë dëmtohen kur janë në pyetje ndarjet financiare. Kjo shumë prej 100 eurosh është simbolike dhe nuk është diçka e madhe për t'u përmendur por, megjithatë, është premtuar. Para zgjedhjeve, kryeministri, ministri i Financave dhe ministrat e tjerë dilnin vazhdimisht dhe tregonin hap pas hapi se ku kishin arritur procedurat. Tani zgjedhjet kanë përfunduar dhe jemi në ditën e tretë pa asnjë deklaram nga qeveria. Askush nuk po thotë nëse mjetet do të ndahen pas një dite, dy apo një jave. Kjo

është arsyeja pse kemi kërkuar sqarim publik", ka thënë Azemi.

Ai ka deklaruar se mungesa e informacionit po krijon dyshime serioze të punëtorët dhe vetë sindikata. I pyetur nëse pret përgjigje nga qeveria, Azemi ka thënë se nuk beson se do të marrë ndonjë reagim personal, por insistoi se institucionet kanë obligim t'u japin llogari qytetarëve.

Azemi e lidhi vonesën edhe me periudhën zgjedhore, duke thënë se para zgjedhjeve procedurat zhvilloheshin me ritëm shumë më të shpejtë. "Para zgjedhjeve punohej natë e ditë për t'i proceduar vendimet dhe për të siguruar që këto mjete të ndaheshin. Tani kanë kaluar



tri ditë dhe nuk ka asnjë lëvizje konkrete. Kjo të shtyn të mendosh se ndoshta këto pagesa janë përdorur si premtim

elektoral dhe jo si masë e mirëfilltë sociale. Shpresoj të jem gabim, por faktet aktuale po krijojnë dyshime", ka thënë ai.

## ASK-ja RAPORTON RRRITJE VJETORE TË ÇMIMEVE, INFLACIONI NË KOSOVË 6,8 PËR QIND

**PRISHTINË, 10 QERSHOR** - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) për muajin maj 2026.

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit ishte më i lartë në një mesatare prej 6,8 % në muajin maj 2026 krahasuar me muajin maj 2025. Inflacioni mujor ishte -0,4 % në muajin maj 2026.

Në muajin maj 2026 Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) është rritur me 6,8 % krahasuar me muajin maj 2025. Rritja është ndikuar nga grupet kryesore të COICOP-it: transporti (14,1 %), strehim, ujë, energji elektrike, gaz dhe lëndë të tjera djegëse (13,2 %), pije alkoolike, duhan dhe narkotikë (5,6 %), restorante dhe shërbime akomodimi (5,3 %), ushqime dhe pije joalkoolike (5,1 %), shëndetësi (4,1 %), mobilie dhe



pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje rutinore (3,6 %), kujdesi personal, mbrojtja

sociale dhe mallra e shërbime të ndryshme (3 %), rekreacion, sport dhe kulturë (2,7 %), veshje

dhe këpucë (2,4 %) dhe informacion dhe komunikim (0,2 %). Rënie e çmimeve është

regjistruar në grupin: shërbimet arsimore (-0,6 %).

Në muajin maj 2026 Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) pësoi rënie në një mesatare prej -0,4 % krahasuar me muajin prill 2026. Rënia është ndikuar nga grupet kryesore të COICOP-it: transporti (-2 %), strehim, ujë, energji elektrike, gaz dhe lëndë të tjera djegëse (-0,7 %), ushqime dhe pije joalkoolike (-0,2 %) dhe kujdesi personal, mbrojtja sociale dhe mallra e shërbime të ndryshme (-0,1 %). Ndërkohë, rritje e çmimeve është regjistruar në grupet: pije alkoolike, duhan dhe narkotikë (0,7 %), shëndetësi (0,7 %), mobilie dhe pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje rutinore (0,6 %), informacion dhe komunikim (0,3 %), veshje dhe këpucë (0,3 %) dhe restorante dhe shërbime akomodimi (0,2 %).

## Transparenca dhe llogaridhënia, temë e takimit mes auditores së përgjithshme dhe kryesuesit të KGJK-së

**PRISHTINË, 10 QERSHOR** - Auditorja e përgjithshme, Vlora Spanca, e shoqëruar nga zëvendësauditore i përgjithshëm, Beza Halilaj dhe ndihmësauditoreja e

përgjithshme, Myrvete Gashi-Morina, të mërkurën është pritur në takim nga kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Rrustem Thaqi, ku është diskutuar për

rëndësinë e bashkëpunimit institucional në funksion të transparencës, llogaridhënies dhe qeverisjes së mirë. Gjatë këtij takimi palët shkëmbyen pikëpamje mbi forcimin e

koordinimit ndërinstitucional dhe mbështetjen e proceseve që kontribuojnë në rritjen e efikasitetit, integritetit dhe performancës institucionale.



# SOCIALIZMI I GJENERATËS Z



Kohë të ndryshme frymëzojnë grupe të ndryshme idesh të majta. Pas Luftës së Dytë Botërore, veçanërisht në Europë, socializmi mori forcë nga industria e rëndë, me sindikatat e fuqishme. Ai nuk synonte të shfuqizonte kapitalizmin, por ta menaxhonte atë, duke shtetëzuar shërbimet publike dhe duke rishpërndarë të ardhurat në shkallë të gjerë. Pas krizës financiare të viteve 2007–2009, “socialistët millenials”, siç i quajti The Economist, argumentuan se modeli evropian i pasluftës kishte krijuar udhëheqës tepër të largët nga punëtorët e zakonshëm dhe tepër të vetëkënaqur përballë ndryshimeve klimatike. Zgjidhja e tyre ishte vendosja e punonjësve në bordet e kompanive, krijimi i kooperativave në pronësi të punëtorëve dhe subvencionimi i teknologjive të gjelbra, me synimin për të krijuar një kapitalizëm më të qëndrueshëm, më të drejtë dhe më ekologjik. Tani vala më e fundit e socializmit po zgjerohet. Ajo ushqehet pjesërisht nga zemërimi për krizën humanitare të shkaktuar nga lufta e Izraelit në Gaza. Por për shumë votues, Gaza sa ka ardhur e po përfaqëson diçka më të madhe: ndjesinë se qeveritë e tyre

shpenzojnë vëmendje dhe para për çështje të tjera, ndërsa neglizhojnë problemet e qytetarëve të tyre në vend. Ata kërkojnë versionin e shekullit XXI të “marrëveshjes së drejtë”, që u ofroi amerikanëve Theodore Roosevelt në vitin 1904. Sot kjo do të thotë të përballësh me një sistem të dëmtuar që pasuron interesat e fuqishme. Sipas këtij argumenti, ekonomia moderne dëmton këdo që nuk është në listën e miliarderëve të Forbes. PBB-ja është më e lartë se kurrë, por qiratë janë tepër të larta, dreka kushton 28 dollarë dhe është e vështirë të gesh një punë të mirë. Socialistët e rinj duan që shteti të përcaktojë çmimet e shumë mallrave dhe shërbimeve, veçanërisht të nevojave bazë si ushqimi dhe qiraja. Aty ku duhen para, ato do të sigurohen, pothuajse ekskluzivisht, duke taksuar më të pasurit. Kjo është një formë politike që nuk u bën thirrje nocioneve të së mirës së përbashkët, si valët e mëparshme të socializmit, por interesit të ngushtë vetjak të njerëzve: “Ma ul qiranë! Ma ul faturën! Më jep autobusë falas! Mbroje vendin tim të punës!” Zgjidhjet janë naive dhe shpesh të pazbatueshme. Por mesazhi është kaq i thjeshtë dhe tërheqës, sa ky socializëm i Gjeneratës Z po fiton

mbështetës në të gjithë botën demokratike. Zoharan Mamdani, kryetari i ri socialist i Nju Jorkut, është një prej tyre. Katie Wilson, një tjetër figurë e së majtës, drejton qytetin e Seattle-it. Kandidatë të majtë radikalë si Graham Platner në Maine dhe Abdul El-Sayed në Michigan shpresojnë të bëhen senatorë në zgjedhjet e mesmandatit në nëntor. Në Wisconsin, një tjetër figurë e majtë, Francesca Hong, po ngjitet në sondazhe për postin e guvernatores. Tregjet e basteve e rendisin Alexandria Ocasio-Cortez, kongresmene socialiste nga Nju Jorku, të dytën pas Gavin Newsom si kandidaten më të mundshme demokrate për presidente në vitin 2028. Në Kanada, Avi Lewis, bashkëshorti i Naomi Klein, autore e njohur e së majtës radikale, së fundmi u bë lider i Partisë së Re Demokratike, partia e tretë më e madhe në vend. Në Britani, Partia e Gjelbër, e udhëhequr nga Zack Polanski, po fiton terren. Në Gjermani, partia e majtë Die Linke po arrin nivelet më të larta të mbështetjes prej vitesh. Në Francë, Jean-Luc Mélenchon, një figurë veterane e së majtës, po sheh drejt garës presidenciale të vitit të ardhshëm. **Mamdani dëshiron të ngrijë qiratë për apartamentet me qira të subvencionuar në Nju Jork, të**

**hapë dyqane ushqimore në pronësi të bashkisë që shesin produkte bazë me çmime të ulëta dhe të ofrojë kujdes falas për fëmijët deri në moshën pesë vjeç.** Die Linke, në zgjedhjet e fundit rajonale, premtoi heqjen e të gjitha tarifave nga çerdhja deri në universitet. Të Gjelbrit e zotit Polanski do të vendosnin kontroll mbi qiratë dhe do t'i bënin autobusët falas për të rinjtë; Të Gjelbrit australianë do të dëshironin ta bënin falas të gjithë transportin publik. “Mendoni Costco-n, por të administruar si një shërbim publik”, thotë zoti Lewis për planin e tij për të krijuar dyqane ushqimore publike në mbarë Kanadanë. Votuesit e refuzuan socializmin e millenials-ëve. Në vitin 2019, Jeremy Corbyn, një përfaqësues i brezit të baby-boomers, i adhuroar nga shumë të rinj britanikë, e çoi Partinë Laboriste në rezultatin e saj më të dobët që prej vitit 1935. Bernie Sanders, fytyra më e njohur amerikane e atij lëvizjeje, humbi garën për kandidimin presidencial demokrat në vitet 2016 dhe 2020. Në Francë, Mélenchon nuk arriti të hynte në balotazhin presidencial. Socialistëve iu desh të kërkonin një qasje të re. Ekonomia pas pandemisë ua ofroi mundësinë. Në vitet 2020 është krijuar një

hendek i paprecedentë mes ekonomisë në letër dhe ekonomisë së përjetuar nga njerëzit. Edhe pse bota e pasur gëzon papunësi të ulët, të ardhura familjare reale rekord dhe tregje aksionesh në rritje të fortë, njerëzit rrallëherë kanë qenë kaq pesimistë. Që nga viti 2022, besimi i konsumatorëve amerikanë ka qëndruar pranë niveleve më të ulëta historike. Gjatë pandemisë, 20% e evropianëve mendonin se kostoja e jetesës ose strehimi ishte një nga dy problemet më të mëdha me të cilat përballlej vendi i tyre. Tani këtë e mendojnë 36%, ndërsa shqetësimet për ndryshimet klimatike, krimin, papunësinë dhe emigracionin po zbehen. James Meadway, një mendimtar socialist, e përmbledh besimin e së majtës kështu: “Rritja ekonomike është shkëputur nga përmirësimi i standardeve të jetesës.”

## Lakmia është e mirë kur është e imja

Njerëzit fajësojnë si bizneset, ashtu edhe shtetin për gjendjen e tyre. Një sondazh i vitit 2024 nga Navigator, një kompani kërkimore, zbuloi se tre në pesë amerikanë mendonin se “lakmia e korporatave” ishte një shkak kryesor i inflacionit.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
**'BUJOËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Drenica shpallet kampione në futsall

**SKENDERAJ, 10 QERSHOR** - FC Drenica ka shënuar fitore ndaj FC Prishtinës 01 edhe në ndeshjen e dytë finale, kësaj radhe me rezultat 7-4, duke e siguruar titullin e kampionit në futsall. Pjesa e parë është mbyllur me rezultat 4-1 për

Drenicën, që ishte dominuese dhe e saktë në përfundimin e aksioneve. FC Prishtina 01 e ka nisur furishëm pjesën e dytë, por nuk ka arritur të bëjë diçka më shumë. Drenica ka festuar titullin e parë kampion në histori të klubit,

pas një sezoni fantastik, duke e mbyllur serinë finale me rezultat 2-0. Për këtë sukses historik të Drenicës, presidenti i FFK-së, Agim Ademi, i ka uruar lojtarët dhe stafin e klubit nga Skenderaj. "Urime FC Drenica

për shpalljen kampion dhe për fitimin e titullit të parë në historinë e klubit! Ky sukses i jashtëzakonshëm është dëshmi e punës së palodhshme, profesionalizmit dhe përkushtimit të treguar gjatë gjithë sezoni 2025/26. Ju



## SOT NIS BETEJA PËR KUPËN E BOTËS

**MEXICO CITY, 10 QERSHOR** - Sot (e enjte) nis zyrtarisht edicioni i 23-të i Kupës së Botës, turneu më i madh në historinë e futbollit, i organizuar për herë të parë nga tre vende së bashku: Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Meksika dhe Kanadaja. Turneu do të zgjasë deri më 19 korrik dhe do të përfshijë 48 kombëtare, një

rritje e konsiderueshme krahasuar me formatin e mëparshëm me 32 ekipe. Ndeshja hapëse do të zhvillohet në "Mexico City Stadium", ku vendi organizator, Meksika, do të përballet me Afrikën e Jugut. Ky takim do të shënojë fillimin e një maratone prej 104 ndeshjesh në 16 qytete pritëse të Amerikës së

Veriut. Sipas FIFA-s, Botërori 2026 pritet të jetë më i madhi i organizuar ndonjëherë, duke sjellë më shumë skuadra, më shumë tifozë dhe një shtrirje rekord të garës. Finalja do të luhet më 19 korrik në zonën Nju-Jork-Nju Jersey. Ceremonitë hapëse dhe aktivitetet festive tashmë kanë

nisur në qytetet organizatore, ndërsa miliona tifozë nga e gjithë bota po përgatiten ta ndjekin turneun që pritet të dominojë në skenën sportive globale gjatë javëve të ardhshme. Pretendentë kryesorë për ta fituar Kupën e Botës 2026 janë Spanja, Franca, Brazili, Anglia, Argjentina dhe Portugalia.



## KOSOVA SIGURON LIGËN B DHE 'PLAY-OFF'-in E BOTËRORIT 2027

**PRISHTINË, 10 QERSHOR** - Kombëtarja e Kosovës në konkurrencën e femrave ka shënuar fitore të thellë ndaj Gjibraltarit, me rezultat 8:0, në ndeshjen e fundit të Grupit 2 të Ligës C në kualifikimet për Kupën e Botës 2027, duke realizuar sukses historik me kualifikim në "play-off" si dhe promovim në Ligën B për ciklin e ardhshëm kualifikues. "Dardanet", të vetëdijshme se në këtë ndeshje kanë nevojë për fitore me sa më shumë gola, e kanë nisur furishëm ndeshjen dhe kanë kaluar në epërsi që në minutën e tretë, kur Donjeta Halilaj e ka dërguar topin në rrjetë.

Vetëm katër minuta më vonë, Erëleta Memeti ka realizuar për 2:0, ndërsa Kaltrina Biqkaj e ka trefishuar epërsinë në minutën e 14-të. Memeti ka realizuar golin e saj të dytë personal në minutën e 21-të, duke e çuar rezultatin në 4:0. Para përfundimit të pjesës së parë, Blerita Smaili ka shënuar në minutën e 32-të për rezultatin



5:0. Kosova ka vazhduar dominimin edhe në pjesën e dytë. Modesta Uka ka realizuar golin e gjashtë në minutën e 68, ndërsa Smaili ka shënuar për herë të dytë në minutën e 76. Rezultatit përfundimtar, 8:0, e ka vulosur Gentiana Fetaj në minutën e 84-të. Me këtë fitore bindëse, Kosova

ka përfunduar e para në grup, me pikë të barabarta me Kroacinë (nga 15), por me goldallim më të mirë. "Dardanet" kështu siguruan kalimin në Ligën B për ciklin e ardhshëm kualifikues si dhe pjesëmarrjen në fazën e "play-off"-it të kualifikimeve për Kupën e Botës 2027. Kjo

paraqitje e jashtëzakonshme ka vulosur një cikël shumë të suksesshëm për futbollistet e Kosovës të cilat kanë dëshmuar cilësi dhe karakter të lartë në çdo ndeshje.

### "Dardanet" siguruan "play-off"-in e Botërorit, Ademi: Arritje historike

Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, ka uruar Kombëtaren e Kosovës në konkurrencën e femrave për fitoren ndaj Gjibraltarit dhe kualifikimin në "play-off" për Kupën e Botës 2027. Ai ka thënë se ky sukses përbën një tjetër hap të rëndësishëm në zhvillimin e futbollit të femrave në Kosovë dhe është dëshmi e qartë e përpimit të vazhdueshëm që është bërë vitet e fundit. "Kombëtarja jonë e vajzave e ka përmblytur në mënyrë madhështore rrugëtimin në Grupin 2 të Ligës C për kualifikimet e Kupës së Botës

2027, duke triumfuar si mysafire ndaj Gjibraltarit me rezultat bindës 8:0. Me këtë fitore Kosova siguroi vendin e parë në grup, me pikë të barabarta me Kroacinë, por me goldallim më të mirë. Ky sukses u garanton 'Dardaneve' kalimin në Ligën B për ciklin e ardhshëm kualifikues si dhe pjesëmarrjen në 'play-off'-in e kualifikimeve për Kupën e Botës 2027. Realizimi i këtij objektiv është një arritje historike dhe plotësisht e merituar për vajzat tona të cilat gjatë gjithë këtij cikli dëshmuar karakter të fortë, shpirt gare, përkushtim dhe besim deri në çastin e fundit. Ky sukses përbën një tjetër hap të rëndësishëm në zhvillimin e futbollit të femrave në Kosovë dhe është dëshmi e qartë e progresit të vazhdueshëm që është bërë gjatë viteve të fundit. Përgëzime nga zemra secilës futbolliste dhe stafit teknik në krye me përzgjedhësin Sami Sermahaj për këtë arritje historike. Vazhdoni të na bëni krenarë!", ka shkruar Ademi në rrjetet sociale.



## Vedat Muriqi rikthehet te Fenerbahçe

**STAMBOLL, 10 QERSHOR** - Vedat Muriqi është shumë pranë rikthimit te Fenerbahçe, pasi klubi turk ka arritur marrëveshje me Mallorcan për transferimin e sulmuesit nga Kosova. Sipas raportimeve të gazetarit turk Yagız Sabuncuoglu, marrëveshja mes dy klubeve është mbyllur për shumën prej 15 milionë eurosh. Fenerbahçe do ta paguajë këtë

shumë në këste gjatë tre viteve të ardhshme, ndërsa në marrëveshje është përfshirë edhe një klauzolë që i garanton Mallorcas 10 për qind të vlerës së një shitjeje të ardhshme të lojtarit. Edhe Muriqi ka arritur marrëveshje personale me klubin nga Stambolli dhe ka dhënë dritën e gjelbër për transferimin. Tashmë priten

vetëm hapat formalë për zyrtarizimin e rikthimit të tij në Turqi. Sulmuesi i Kosovës pritet të udhëtojë drejt Stambollit brenda javës së ardhshme, ku do t'u nënshtrohet kontrolleve mjekësore përpara se ta firmosë kontratën e re me Fenerbahçen. Muriqi ka lënë gjurmë gjatë periudhës së tij të parë te Fenerbahçe para se të transferohej te Lazio. Pas

paraqitjeve të shkëlqyera me Mallorcan në La Liga, klubi turk ka vendosur ta rikthejë sërish në radhët e veta, duke e konsideruar një nga përfundimet kryesore për sezonin e ri. Rikthimi i "Piratit" pritet të pritë me entuziazëm nga tifozët e Fenerbahçes të cilët e kujtojnë ende kontributin e tij të mëparshëm me fanellën verdheblu.







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA

# 1992

